



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr.2004 / 11**

**PËR NJËSITË MATËSE**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullorës nr. 2001/ 9 të datës. 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, e në veqanti nenet 5.1 (ç), 9.1.1, 9.3.3, 11.2,

Miraton:

**LIGJIN PËR NJËSITË MATËSE**

Dispozitat e Përgjithshme  
Neni 1

Me këtë Ligj rregullohet përcaktimi i njësive matëse në Kosovë, emërtimi dhe simbolet e tyre, lëmitë dhe fushat e aplikimit, obligimi i përdorimit të këtyre njësive dhe mënyrat e zbatimit të tyre në pajtim me Dokumentin D1, të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Legale (OIML)/ International Document of the International Committee of Legal Metrology: CIML 1975 D.I. No. 1/.

Neni 2

Përdorimi i njësive matëse ligjore është i detyrueshëm në këto fusha:

- a. në lëminë e ekonomisë (prodhimtari, ndërtimtari, energjetikë, idurstri, tregti,), në shërbimet shëndetësore dhe në mbrojtjen e ambientit;
- b. në aktet ligjore e nënligjore, në tekstet shkollore, në kontrata, njoftime, mbishkrime dhe në të gjitha aktet dhe dokumentet tjera zyrtare.

Neni 3

Përkufizimi, vlerësimi dhe mënyrat e përdorimit të njësive matëse përcaktohen me akte nënligjore dhe standarde të pranuar, të cilat i harton Instituti për Metrologji Legale i Kosovës dhe i miraton Ministria për Tregti dhe Industri.

## Njësiti Matëse Neni 4

Njësiti matëse legale në Kosovë janë:

4.1. Njësiti e sistemit ndërkombëtar (në vazhdim: njësiti SI), dhe atë:

- i. Njësiti themelore SI (tabela 1);
- ii. Njësiti e derivuara SI, me emra dhe simbole të veçanta (tabela 2);
- iii. Njësiti e derivuara SI, emrat dhe simbolet e të cilave përfshijnë njësi të derivuara SI, me emra dhe simbole të veçanta (tabela 3).

4.2. Një numër i kufizuar i njësive të lejuara, jashtë sistemit ndërkombëtar SI:

- i. Njësiti jashtë SI të lejuara për përdorim të gjërë (tabela 4);
- ii. Njësiti jashtë SI të lejuara për përdorim, vlerat e të cilave janë përcaktuar eksperimentalisht (tabela 5);
- iii. Njësiti jashtë SI të lejuara për përdorim në raste të posaçme (tabela 6).

4.3. Njësiti tjera jashtë SI të ndaluara për përdorim:

- i. Njësi të derivuara të sistemit CGS, me emërtime të posaçme të ndaluara për përdorim, (tabela 7);
- ii. Njësi jashtë SI të ndaluara për përdorim (tabela 8).

4.4. Parashtesat (prefiksat):

- i. Parashtesat (prefiksat), në SI, (tabela 9);
- ii. Prefiksat për shumëfishat binarë, (tabela 10);
- iii. Krahasime me prefiksat SI, (tabela 11).

4.5. Emrat dhe simbolet e madhësive dhe njësive të sistemit SI dhe jashtë sistemit SI, të paraqitura në paragrafet 1,2,3 dhe 4, të këtij neni, janë dhënë në shtesën nr. 1, që është pjesë përbërëse e këtij ligji.

## Neni 5

Përveq njësive matëse ligjore nga neni 4 i këtij Ligji, në Kosovë mund të përdoren edhe njësiti tjera matëse:

- a. nëse përdorimi i njësive të tilla matëse është pranuar me marrëveshje ndërkombëtare;
- b. nëse për mallin, shërbimin apo të dhënat për eksport jashtë Kosovës, në atë vend përdoren këto njësi matëse.

## Neni 6

Gjatë vënjes në qarkullim të mallit të importuar, shërbimeve apo informacioneve, shënimet e paraqitura në njësitë matëse, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me dispozitat e këtij ligji, të shprehen edhe në njësitë matëse të miratuara me këtë ligj.

## Neni 7

Për bartjen apo përpunimin e të dhënave, njësitë matëse mund të paraqiten me simbole të rregulluara veqanërisht për sisteme me bashkësi të kufizuar të simboleve në bazë të normave ndërkombëtare.

## Neni 8

Mbikqyrjen mbi rregullsinë e njësive matëse e bënë inspeksioni i tregut, kurse ekspertizën mbi njësitë matëse e bënë Instituti i Metrologjisë Legale të Kosovës, me kërkesën e inspeksionit të tregut, Gjykatës, Doganës dhe palëve të tjerë fizik dhe juridik.

## Dispozitat Ndëshkuese

### Neni 9

9.1. Me gjobë prej 1000 € deri 5000 € dënohet personi juridik nëse në qarkullimin e mallrave apo gjatë kryerjes së shërbimeve nuk e përdorë njësinë matëse të rregulluar me këtë ligj (neni 4, 5 dhe 6).

9.2. Për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej 50 € deri 500 € edhe personi përgjegjës në ndërmarrje apo personi tjetër juridik.

### Neni 10

10.1. Me gjobë prej 500 € deri 2500 € dënohet personi juridik nëse në punën e tij i përdor njësitë matëse në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ( neni 4);

10.2. Për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej 50 € deri 500 € edhe personi përgjegjës në ndërmarrje apo personi tjetër juridik.

### Neni 11

11.1. Me gjobë prej 150 € deri 500 € dënohet për kundërvajtje ndërmarrësi nëse njësitë matëse nuk i përdor me emrat dhe simbolet e rregulluara me këtë ligj (neni 4 dhe 5).

11.2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë prej 50 € deri 250 € edhe personi përgjegjës në ndërmarrje apo personi tjetër juridik.

#### Neni 12

Me gjobë prej 150 € deri 500 € dënohet për kundërvajtje personi fizik i cili kryen veprimtari ekonomike me punë vetanake, nëse kryen ndonjëherë nga aktet në nenet 9.,10 dhe 11 të këtij Ligji.

#### Neni 13

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave të këtij ligji derdhën në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

#### Dispozitat Përfundimtare

#### Neni 14

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohen të gjitha aktet tjera normative që rregullojnë lëminë e njësive matëse.

#### Neni 15

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes së tij nga PSSP-ja.

**Ligji Nr.2004 / 11**  
**29 prill 2004**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës**

---

**akademik Nexhat Daci**

## SHTESA NR. 1.

Njësitë matëse themelore të sistemit ndërkombëtar SI për matjen e dukurive dhe të madhësive fizike janë:

<b>Tabela 1: Njësitë themelore SI</b>			
<b><i>Madhësia themelore</i></b>		<b><i>Njësia themelore</i></b>	
<b><i>Emri</i></b>	<b><i>Simboli</i></b>	<b><i>Emri</i></b>	<b><i>Simboli</i></b>
gjatësia	$l$	metri	m
masa	$m$	kilogrami	kg
koha	$t$	sekonda	s
intensiteti i rrymës elektrike	$I$	amperi	A
temperatura termodinamike	$T$	kelvini	K
sasia e materies	$n$	moli	mol
intensiteti i dritës	$I_v$	kandela	cd

**Tabela 2: Njësitë e derivuara SI me emra dhe simbole të veçantë**

<i>Madhësia e derivuar</i>	<b>Njësia e derivuara SI</b>			
	<b>Emri</b>	<b>Simboli</b>	<b>Shprehja përmes njësive tjera SI</b>	<b>Shprehja përmes njësive themelore SI</b>
këndi në rrafsh	radian	rad	-	$m \cdot m^{-1} = 1$
këndi hapësinor	steradian	sr	-	$m^2 \cdot m^{-2} = 1$
frekuenca	herc	Hz	-	$s^{-1}$
forca	njuton	N	-	$m \cdot kg \cdot s^{-2}$
shtypja	paskal	Pa	$N/m^2$	$m^{-1} \cdot kg \cdot s^{-2}$
energjia, puna, sasia e nxehtësisë	xhul	J	$N \cdot m$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2}$
fuqia, fluksi radiant	vat	W	$J/s$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3}$
ngarkesa elektrike	kulon	C	-	$s \cdot A$
ndryshimi i potencialit elektrik, forca elektromotore	volt	V	$W/A$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-1}$
kapaciteti elektrik	farad	F	$C/V$	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^4 \cdot A^2$
rezistenca elektrike	ohm	$\Omega$	$V/A$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-2}$
përqeshmëria elektrike	siemens	S	$A/V$	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^3 \cdot A^2$
fluksi magnetik	veber	Wb	$V \cdot s$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-1}$
induksioni magnetik	tesla	T	$Wb/m^2$	$kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-1}$
Induktiviteti	henri	H	$Wb/A$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-2}$
temperatura e Celsiusit	shkallë Celsius	$^{\circ}C$	-	K
fluksi i dritës	lumen	lm	$cd \cdot sr^{(c)}$	$m^2 \cdot m^{-2} \cdot cd = cd$
ndriqimi	luks	lx	$lm/m^2$	$m^2 \cdot m^{-4} \cdot cd = m^{-2} \cdot cd$
aktiviteti i radionuklidit	bekerel	Bq	-	$s^{-1}$
doza e absorbuar e rrezatimit jonizues, energjia specifike	grej	Gy	$J/kg$	$m^2 \cdot s^{-2}$
doza ekuivalente e rrezatimit jonizues	sivert	Sv	$J/kg$	$m^2 \cdot s^{-2}$
aktiviteti katalitik	katal	kat		$s^{-1} \cdot mol$

**Tabela 3: Njësive e derivuara SI emrat dhe simbolet e të cilave përfshijnë njësi të derivuara SI me emra dhe simbole të veçantë**

<b>Madhësia e derivuar</b>	<b>Njësia e rrjedhur SI</b>	
	<b>Emri</b>	<b>Simboli</b>
viskoziteti dinamik	paskal sekonda	Pa · s
momenti i forcës	njuton metër	N · m
tensioni sipërfaqësor	njuton per metër	N/m
shpejtësia këndore	radian per sekondë	rad/s
nxitimi këndor	radian për sekondë në katror	rad/s <sup>2</sup>
densiteti i fluksit termik (irradiance)	vat për metër katror	W/m <sup>2</sup>
termokapaciteti, entropia	xhul për kelvin	J/K
termokapaciteti specifik, entropia specifike	xhul për kilogram kelvin	J/(kg · K)
energjia specifike	xhul për kilogram	J/kg
përçueshmëria termike	vat për metër kelvin	W/(m · K)
densiteti i energjisë	xhul për metër kub	J/m <sup>3</sup>
intensiteti i fushës elektrike	volt për metër	V/m
densiteti I ngarkesës elektrike	kulon për metër kub	C/m <sup>3</sup>
densiteti I fluksit elektrik	kulon për metër katror	C/m <sup>2</sup>
permitiviteti	farad për metër	F/m
permeabiliteti	henri për metër	H/m
energjia molare	xhul për mol	J/mol
entropia molare, termokapaciteti molar	jul për mol kelvin	J/(mol · K)
ekspozicioni (rrezet x dhe γ) i rrezatimit jonizues	kulon për kilogram	C/kg
shkalla e dozës së absorbuar të rrezatimit jonizues	grej për sekondë	Gy/s
intensiteti i rrezatimit	vat për steradian	W/sr
ndriqushmëria	vat për metër katror steradian	W/(m <sup>2</sup> · sr)
koncentrimi katalitik	katal për metër kub	kat/m <sup>3</sup>

Tabela 4: Njësitë jashtë SI të pranuar për përdorim të gjërë				
Madhësia		Njësia		
Emri	Simboli	Emri	Simboli	Vlera në njësi SI
koha	$t$	minuta ora dita	min h d	1 min = 60 s 1 h = 60 min 1 d = 24 h
këndi në rrafsh	$\varphi$	shkalla minuta sekonda	° ' "	1 ° = $(\pi/180)$ rad 1' = $(1/60)^\circ$ 1" = $(1/60)'$
vëllimi	$V$	litri	L	1 L = 1 dm <sup>3</sup>
masa	$m$	tonelata	t	1 t = 10 <sup>3</sup> kg
log		neperi	Np	1 Np = 1
ln		beli	B	1 B = $(1/2)\ln 10$ Np

Sqarim:

Lejohet përdorimi e disa njësive që kanë hyrë në përdorim të thellë, siç janë:

- Njësitë tradicionale matematikore për matjen e këndeve: *shkalla këndore*, *minuti këndor* (arkminuti) dhe *sekonda këndore* (arksekonda).
- Njësitë tradicionale për matjen civile të kohës (minuti, ora, dita, dhe viti).
- Dy njësi metrike që përdoren shpesh në jetën e përditshme: *litri* për vëllim dhe *tona* për masa të mëdha.

Dy njësi logaritmike: neperi dhe beli.

**Tabela 5: Njësitë jashtë SI të lejuara për përdorim vlerat e të cilave janë përcaktuar eksperimentalisht**

<b>Madhësia</b>		<b>Njësia</b>		
<b>Emri</b>	<b>Simboli</b>	<b>Emri</b>	<b>Simboli</b>	<b>Vlera në njësi SI</b>
<i>energji</i>	E	elektronvolti	eV	1 eV = 1,602 18*10 <sup>-19</sup> J (përafërsisht)
<i>masa</i>	m	njësia e unifikuar atomike e masës	u	1 u = 1,660 54*10 <sup>-27</sup> kg (përafërsisht)
<i>gjatësia</i>	<i>l</i>	njësia astronomike	ua	1 ua = 1,495 98*10 <sup>11</sup> m (përafërsisht)

Sqarim:

Lejohet përdorimi i disa njësive shkencore jashtë SI të cilat paraqesin konstanta të rëndësishme në shkencë siç janë: njësia astronomike për gjatësi, njësia atomike e masës apo daltoni për masë dhe elektron volti për energji të cilat janë dhënë në tabelën 5.

Tabela 6: Njësi jashtë SI, të pranuar për përdorim në raste të posaqme			
<i>Madhësia</i>	<i>Njësia</i>	<i>Simboli</i>	<i>Vlera në njësitë SI</i>
gjatësia	milë detare		1 milë detare = 1852 m
shpejtësia	knot		1 milë nautike për orë = (1852/3600) m/s
densiteti linear	teks		1 teks=10 <sup>-6</sup> kg/m=1mg/m
presioni / lëngjëve të trupit të njeriut	milimetër kolonë me merkur	mmHg	1 mmHg=133322Pa
sipërfaqja	ar	a	1 a = 1 dam <sup>2</sup> = 10 <sup>2</sup> m <sup>2</sup>
	hektar	ha	1 ha = 1 hm <sup>2</sup> = 10 <sup>4</sup> m <sup>2</sup>
shtypja	bar	bar	1 bar = 0.1 MPa = 100 kPa = 1000 hPa = 10 <sup>5</sup> Pa
gjatësia	angstrom	Å	1 Å = 0.1 nm = 10 <sup>-10</sup> m
seksioni	barn	b	1 b = 100 fm <sup>2</sup> = 10 <sup>-28</sup> m <sup>2</sup>

Sqarim:

Lejohet edhe përdorimi i disa njësive metrike dhe jometrike të cilat janë në përdorim tradicional në lëmenj të ndryshëm të shkencës. Përdorimi i këtyre njësive duhet kuptuar në atë mënyrë që me rastin e çdo përdorimi të jepet korelacioni i tyre me njësitë përkatëse ndërkombëtare – SI. Këtu bëjnë pjesë këto njësi:

- mila nautike si njësi e shpejtësisë dhe nyja (**knot**) njësi e shpejtësisë që tradicionalisht përdoren në detari dhe meteorologji.
- ari dhe hektari njësi të shpeshta për sipërfaqe (në Shqipëri me të madhe përdoret edhe njësia e vjetër me origjinë turke – dulum që ka 10 ari).
- bari si njësi e shtypjes me shumëfishat dhe nënfishat e ndërtuar sipas parashtesave përkatëse siç është milibari në meteorologji dhe kilobari në teknikë.
- angstromi (**ångström**) si njësi e gjatësisë në fizikë dhe barni si njësi e seksionit efikas në fizikën nukleare.

**Tabela 7: Njësi të derivuara të sistemit CGS me emërtime të posaçme**

<i>Madhësia</i>	<i>Emri</i>	<i>Simboli</i>	<i>Vlera në njësi SI</i>
<i>puna, energjia</i>	erg	erg	1 erg = $10^{-7}$ J
<i>forca</i>	din (dyn)	dyn	1 dyn = $10^{-5}$ N
<i>viskoziteti</i>	puaz (poise)	P	1 P = 1 dyn s/cm <sup>2</sup> = 0.1 Pa s
	stoks (stokes)	St	1 St = 1 cm <sup>2</sup> /s = $10^{-4}$ m <sup>2</sup> /s
<i>induksioni magnetik</i>	gaus	G	1 G $\approx 10^{-4}$ T
<i>intensiteti i fushës magnetike</i>	oersted	Oe	1 Oe $\approx (1000/4\pi)$ A/m
<i>fluksi magnetik</i>	maksuell	Mx	1 Mx $\approx 10^{-8}$ Wb
<i>shkëlqimi</i>	stilb	sb	1 sb = 1 cd/cm <sup>2</sup> = $10^4$ cd/m <sup>2</sup>
<i>ndriçueshmëria</i>	fot (phot)	ph	1 ph = $10^4$ lx
<i>nxitimi</i>	gal	Gal	1 Gal = 1 cm/s <sup>2</sup> = $10^{-2}$ m/s <sup>2</sup>

Sqarim:

Në tabelën 7 janë dhënë njësi që mund të hasen në literaturë dhe preferohet që të evitohen nga përdoruesit. Me ndihmën e kësaj table ato shndërrohen në njësi SI dhe pastaj, vlerat bëhen të lejuara për përdorim.

**Tabela 8: Njësi jashtë SI të ndaluara për përdorim**

<b>Madhësia</b>	<b>Emri i njësisë</b>	<b>Simboli</b>	<b>Vlera në njësi SI</b>
<i>aktiviteti i radionukleideve</i>	kiri	Ci	1 Ci = $3.7 \cdot 10^{10}$ Bq
<i>ekspozimi i rrezeve iks apo gama</i>	rëntgen	R	1 R = $2.58 \cdot 10^{-4}$ C/kg
<i>doza e absorbimit të ionizimit</i>	rad	rad	1 rad = 1 cGy = $10^{-2}$ Gy
<i>doza ekuivalente</i>	rem	rem	1 rem = 1 cSv = $10^{-2}$ Sv
<i>gjatësia</i>	njësia X		1 njësia X $\approx 1,002 \cdot 10^{-4}$ nm
<i>nënfish i njësisë tesla</i>	gama	$\gamma$	1 $\gamma$ = 1 nT = $10^{-9}$ T
	jansky	Jy	1 Jy = $10^{-26}$ W · m <sup>-2</sup> · Hz <sup>-1</sup>
<i>gjatësia</i>	fermi		1 fermi = 1 fm = $10^{-15}$ m
<i>masa</i>	karati metrik		1 karat metrik = 200 mg = $2 \cdot 10^{-4}$ kg
<i>shtypja</i>	torr	Torr	1 Torr = (101 325/760) Pa
	atmosfera normale	atm	1 atm = 101 325 Pa
<i>nxehtësia</i>	kaloria	cal	1 cal = 4,1868 J
<i>gjatësia</i>	mikron	$\mu$	1 $\mu$ = 1 $\mu$ m = $10^{-6}$ m

Sqarim:

Në tabelën 8 janë dhënë njësi jashtë SI dhe preferohet që të evitohen nga përdoruesit. Nëse hasen në literaturë, ato së pari duhet të shndërrohen në njësi SI sipas tabelës e pastaj vlerat e fituara bëhen të përdorshme në SI.

**Tabela 9: Parashtesat-prefiksati SI**

Faktori	Emri	Simboli
$10^{24}$	Jota	Y
$10^{21}$	Zeta	Z
$10^{18}$	Ekza	E
$10^{15}$	Peta	P
$10^{12}$	Tera	T
$10^9$	Giga	G
$10^6$	mega	M
$10^3$	kilo	K
$10^2$	hekto	H
$10^1$	deka	da

Faktori	Emri	Simboli
$10^{-1}$	deci	d
$10^{-2}$	centi	c
$10^{-3}$	mili	m
$10^{-6}$	mikro	$\mu$
$10^{-9}$	nano	n
$10^{-12}$	piko	p
$10^{-15}$	femto	f
$10^{-18}$	ato	a
$10^{-21}$	zepto	z
$10^{-24}$	jokto	y

Sqarim:

Parashtesat SI shërbejnë për krijimin e njësive decimale. Njësitë decimale krijohen:

- nga të gjitha njësitë themelore SI, përpos njësisë kilogram-kg (tab.2).
- nga të gjitha njësitë e derivuara SI të emërtuara posaqarisht, përpos njësisë shkallë celzius- $^{\circ}\text{C}$  (tabela 3).
- Nga këto njësi jashtë SI të lejuara për përdorime të posaqme të emërtuara posaqarisht: litër (L), teks (tex), bar (bar), elektronvolt (eV), dhe varn (var).

**Tabela 10: Prefiksat për shumëfishat binarë**

Emri	Simboli	Faktori
kibi	Ki	$2^{10} = 1024$
mebi	Mi	$2^{20} = 1\,048\,576$
gibi	Gi	$2^{30} = 1\,073\,741\,824$
tebi	Ti	$2^{40} = 1\,099\,511\,627\,776$
pebi	Pi	$2^{50} = 1\,125\,899\,906\,842\,624$
eksbi	Ei	$2^{60} = 1\,152\,921\,504\,606\,846\,975$
zebi	Zi	$2^{70} = 1\,180\,591\,620\,717\,411\,303\,424$
jobi	Yi	$2^{80} = 1\,208\,925\,819\,614\,629\,174\,706\,176$

Sqarim:

Në dhjetorin e viti 1998 **IEC (International Electrotechnical Commission)**, ka aprovuar emrat dhe simbolet standarde të prefiksive të shumëfishave binarë. Këta prefiksa janë dhënë në tabelën 7. Emrat janë formuar nga dy shkronjat e parë e parashtesës ndërkombëtare për shumëfisha (*ki, me, gi, ti, pi, ex, ze, yo*), nga shkronjat *bi* që do të thotë *binary* që mund të zbatohen në njësinë bit apo byte. Simbolet e shumëfishave binarë janë formuar nga simboli i shumëfishit ndërkombëtar – SI (K, M, G, T, P, E, Z, Y) dhe shkronjës *i* (Ki, Mi, Gi, Ti, Pi, Ei, Zi, Yi). Në këtë rast shumëfishi kilo ka marrë simbolin K a mund të merret edhe k.

**Tabela 11: Krahasime me prefiksat SI**

një kibibit	$1 \text{ Kibit} = 2^{10} \text{ bit} = \mathbf{1\,024 \text{ bit}}$
një kilobit	$1 \text{ kbit} = 10^3 \text{ bit} = \mathbf{1\,000 \text{ bit}}$
një mebibajt	$1 \text{ MiB} = 2^{20} \text{ B} = \mathbf{1\,048\,576 \text{ B}}$
një megabajt	$1 \text{ MB} = 10^6 \text{ B} = \mathbf{1\,000\,000 \text{ B}}$
një gibibajt	$1 \text{ GiB} = 2^{30} \text{ B} = \mathbf{1\,073\,741\,824 \text{ B}}$
një gigabajt	$1 \text{ GB} = 10^9 \text{ B} = \mathbf{1\,000\,000\,000 \text{ B}}$

Sqarim:

Në tabelën 11 shihen disa shembuj të krahasimit të njësive binare me njësi ndërkombëtare.